



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 5.10. 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar; Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë; Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha, anëtarë.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

***Kryesuesi i Komisionit** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

Diskutim lidhur me arrestimin nga Serbia të pjesëtarit të Policisë së Kosovës, nënkolonel Nehat Thaçi.

Kryesuesi, fillimisht theksoi se ky takim është thirrur për të diskutuar lidhur me arrestimin nga autoritet serbe, të z. Nehat Thai, duke shtuar që ky takim është propozuar nga znj. Ganimete Musliu, ndërsa nga Komisioni do të ofrohen konkluzione, dhe kontributin, për aq sa lejojnë kompetencat për lirim të z. Thaçi. Po ashtu, theksoi që arrestimi i z. Nehat Thaçi nga autoritete serbe, dëshmon për politikën e vjetër të Serbisë, në raport me Kosovën dhe kjo nuk i ndihmon raportet apo rregullimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. Në përfundim të takimit, do të bëhet thirrje autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare, që sa më shpejt të lirohet z. Thaçi dhe të ndërpriten veprime të tilla.

Ganimete Musliu, theksoi se për rastin e arrestimit të z. Nehat Thaçi, ka mundur të thirret takimi edhe më herët nga Komisioni, duke shtuar se Komisioni do të dalë me rekomandime ose edhe me kërkesa të drejtpërdrejta për institucionet e vendit, duke theksuar se ministrja, znj. Edita Tahiri, që merr pjesë në negociatat në Bruksel, të kërkojë që të hiqen nga lista, zyrtarët shtetërorë për çështje që akuzohen nga viti 1998-1999, deri në përfundimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më tutje, theksoi se ka pasur edhe më herët raste të tilla dhe nuk ka asnjë vlerë që të vazhdohen bisedimet, përderisa ka raste të tilla. Për këtë arsye, konsideroi se duhet të kemi reciprocitet ose duhet marrë vendim për vazhdimin ose jo të bisedimeve, duke shtuar që kjo çështje është dashur të trajtohet me kujdes më të madh, edhe pse institucionet e vendit janë duke u marrë, por opinioni duhet sqaruar më shumë për këtë çështje.

Gjithashtu, shtoi se edhe diaspora, e cila udhëton përmes shtetit serb, duhet t'u bëhet e ditur që të shmangin këtë linjë të udhëtimit, pasi me punën dhe bisedimet që po bëhen, nuk mundet të garantohet lëvizja e lirë e cila është shkelur tashmë. Kësaj çështjeje, duhet thënë mjaft dhe duhet të sillemi si shtet në raste të tilla.

Nuredin Ibishi, theksoi se arrestimi i z. Nehat Thaçi, komandant i stacionit policor në jug të Mitrovicës, është një goditje e rëndë për personin që ka kaluar të gjitha procedurat e verifikimit dhe kjo bie ndesh me aspektin territorial të autoriteteve të Kosovës, përfshirë policinë dhe gjyqësinë. Më tutje, theksoi se janë njëqind e pesëdhjetë persona që kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së dhe janë në listë të INTERPOL-it, dhe Serbia duke qenë pjesë e tij, ka mundësi të keqpërdor të dhënat në këtë situatë. Mosbashkëpunimi i brendshëm dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, janë faktorë në këtë drejtim dhe shprehu shqetësimin për këtë rast të ndodhur, duke kërkuar një qasje më të drejtpërdrejtë nga institucionet e vendit.

Rexhep Selimi, duke iu referuar rastit të arrestimit të z. Nehat Thaçi, theksoi se pas arrestimit të tij është kërkuar informacion nga kryeministri, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Punëve të Jashtme, por që nuk është dhënë sqarim, për arsyet dhe procedurat e arrestimit. Më tutje, theksoi se nuk është rasti i parë që nga autoritetet serbe arrestohen zyrtarë të policisë, një rast i tillë ka ndodhur në Dumnice, vite me herët, ku janë arrestuar dy policë dhe autoritet e vendit nuk janë sjellë në mënyrë të duhur. Kjo situatë pasqyron “marrëdhëniet normalizuara mes Kosovës dhe Serbisë”, ndërkohë Qeveria e Kosovës nuk po bën asnjë hap për të vepruar në përgjigje të veprimeve nga shteti serb dhe as nuk respektohen ligjet dhe Kushtetuta për arrestimin e personave, të cilët do të duheshin të arrestohen. Raportet më të mira me Serbinë do të ndërtoheshin me aplikimi e reciprocitetit, ekonomik, të sigurisë dhe në çdo fushë tjetër. Prandaj, vlerësoi, që për të dhënë përgjigjeje për këtë rast, do të duhej të japi përgjigjeje përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Jashtme të Kosovës.

Kryesuesi, theksoi se, edhe pse nuk është bërë kërkesë për të ftuar autoritetet përkatëse të vendit, Komisioni do t'i ftojë për aq sa vlerësohet nga Komisioni.

Zafir Berisha, sa i përket rastit të arrestimit të z. Thaçi, theksoi se edhe Ministria e Punëve të Jashtme është duke u marrë me këtë gjë, ndërsa themelimin e një task-force për t'u marrë me rastin e z. Thaçi, është e panevojshme, sepse Kosova ka të gjithë mekanizmat adekuatë. Më tutje, theksoi se gjëja e parë që duhet bërë është tërheqja nga bisedime e znj. Edita Tahiri. Komisioni do të ishte mirë të dilte me një deklaratë, për të kërkuar nga institucionet që të jenë më autoritative, në raport me Serbinë. Shteti serb, edhe në kushtetutën e vet, e trajton Kosovën si pjesë të saj dhe mund të aludojë që është duke u marrë *“me qytetarët e saj”*. Më tutje, shtoi se ndërprerja e bisedimeve është hap i nevojshëm, pasi që sjellja e shtetit serb ndjek politika, ku Kosova si shtet, nuk është duke mundur të përcjellë, dhe se Kosova duhet të aplikojë reciprocitetin, përfshirë edhe sektorin e sigurisë.

Fadil Demaku, theksoi se institucionet e shtetit duhet të merren me fenomenin që po ndodh dhe ka ndodhur edhe në të kaluarën. Institucionet duhet të kalojnë fazën deklarative dhe duhet reagim me përgjegjësi shtetërore nga të gjitha autoritetet e Kosovës, tek të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë dhe përgjegjësia adekuate e shtetit serb, në të gjitha aspektet, në raport me Kosovën. Më tutje, theksoi se si shtet duhet të mbrojmë vlerat dhe interesat, duke mos u nënshtruar dhe kërkuar mëshirë nga askush, dhe si institucione, të reagojnë brenda përgjegjësi që kanë.

Anton Quni, theksoi se deri tani është arritur të bëhet identifikimi i pesëdhjetë mijë luftëtarëve që gëzojnë të drejtën e veteranit të luftës, por që në këndvështrimin e Serbisë janë *“terroristë”* dhe kandidatë potencialë, që nëse kalojnë kufirin me Serbinë, mund të arrestohen. Gjithashtu, gjatë viteve 1998-1999, Serbia ka përdorur informacionet policore dhe ushtarake, mbi njëqind mijë trupa, ndërsa nga ana e Kosovës nuk ka qëndrim ndaj forcave okupuese dhe se janë aktive në ndjekjen e çlirimtarëve, ndërsa Kosova është pasive në raport me okupuesin, duke tentuar në krijimin e opinionit se Kosova nuk ka zhvilluar një luftë të drejtë dhe se aspekti i amnistisë së përgjithshme, nuk ka qenë temë e bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë. Roli i Komisionit nuk mund të jetë vendimmarrës, por mund të nxisim institucionet kompetente, që të dakordojnë të gjitha aktivitetet dhe të jenë në mbrojtje të qytetarëve të Kosovës, përderisa këto institucione nuk kanë pasur ndonjë performancë, në nivelin e duhur dhe kanë qenë pasivë në raport me krimet e regjimit serb në Kosovë.

Ganimete Musliu, sa i përket mospranisë së përfaqësuesve të ministrive që mund të raportonin për rastin e arrestimit të z. Thaçi, theksoi se në këtë takim mund të marrim vendim, përveç tjerash të ftohen për raportim autoritete përkatëse. Gjithashtu, kërkoi që nga autoritet shtetërore, të mbahet e informuar familja e z. Thaçi, ku pas vizitës që i ka bërë familjes së tij, ka kuptuar që njoftohen vetëm përmes mediave.

Bojan Mitiq, thekso se është i befasuar për kohën e shkurtër, për të cian është thirrur mbledhja, pasi përveç punës në Komision, ka edhe obligime të tjera. A është qëllimi që mos të jenë prezentë disa anëtarë apo ku është çështja?

Sa i përket arrestimit të z. Nehat Thçi, theksoi se nuk e di, pse është arrestuar dhe mendon që ky arrestim ka prapavijë tjetër, pasi z. Thaçi ka kaluar edhe herë të tjera kufirin dhe nuk është

arrestuar, dhe se në pyetjet e ngritura dikush tjetër duhet të japë përgjigje. Pra, nëse nuk ka informacione si Komision, mund të japim këshilla, por nuk mund të bëhet më shumë.

Kryesuesi, lidhur me shpejtësinë e thirrjes së mbledhjes, theksoi se kjo është bërë brenda afateve kohore, të parapara me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës dhe qëllimi i këtij takimi është për të diskutuar këtë çështje dhe për të identifikuar autoritete kompetente. Ndërsa, referuar fjalës së z. Mitiq, i cili tha se z. Nehat Thaçi ka kaluar kufirin edhe më herët, shtoi se kjo është dëshmi që autoritetet serbe kanë marrë vendim politik për arrestimin e tij, me qëllim për thellimin e krizës. Prandaj, edhe nga anëtarët e Komisionit u kërkua reciprociteti, në raport me shtetin serb, ndërsa sa i përket kohës së shkurtër të thirrjes së mbledhjes, shtoi se asgjë nuk është bërë me qëllim, por sipas nevojës dhe kërkesës për këtë mbledhje.

Qerim Bajrami, lidhur me arrestimin e z. Thaçi, theksoi se kur arrestohet komandanti i një stacioni policor, kjo mund t'i ndodhë çdo qytetari, pasi në këtë rast është arrestuar komandanti i stacionit policor të Mitrovicës, ku ka integrim të komunitetit serb dhe kjo ngjarje nuk është e rëndësishme, pasi dikush po i dikton këto situata. Në vend të avancimit, shkohet mbrapa. Më tutje, theksoi se roli i komunitetit ndërkombëtar është shumë i rëndësishëm, duke shtuar se në rast se një përfaqësuesi të Serbisë do t'i ndalohej hyrja, do të kishte intervenime për lejimin e vizitës, duke vlerësuar se tani e kanë rastin të ndërhyjë komuniteti ndërkombëtar, dhe në raport me Serbinë, duhet të zbatohet reciprociteti.

Zafir Berisha, propozoi që pas këtij takimi, në emër të Komisionit, t'i dërgohet letër institucioneve kompetente me kërkesat përkatëse dhe pasnesër të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, në mënyrë që të dihet më saktë, nëse ka pasur lëvizje të mëhershme nga z. Nehat Thaçi.

Kryesuesi, shtoi se për aq sa është në kompetencë e Komisionit, do të kërkohet nga institucionet ndërmarrja e masave, por pa dashur të ndërhyjmë dhe të marrim role të tjera.

Rexhep Selimi, shtoi se nga ky takim, të dilet me një deklaratë të përbashkët, duke u bazuar në atë që u thanë nga anëtarët e Komisionit, ku në tekst të kërkohet edhe ndërprerja e bisedimeve me Serbinë, si dhe thirrje për institucionet që mbikëqyren nga Komisioni, por edhe kërkesë ndaj Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të japë informacione.

Kryesuesi, propozoi deklaratën me konkluzione, e cilat u plotësua me komente shtesë nga anëtarët e Komisionit, me rastin e arrestimit të z. Nehat Thaçi.

Rexhep Selimi, propozoi që në tekst të futet edhe çështja e bisedimeve në raport me Serbinë dhe sa i përket marrëdhënieve që është cekur të riformulohet.

Anton Quni, theksoi se rasti i ndodhur është sabotimi i ndërtimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë dhe ndoshta arrestimi i z. Thaçi është arsyeja që të ndërpriten bisedimet, duke shtuar se Komisioni duhet të përmbahet dhe kjo çështje të lihet në diskrecionin e autoriteteve të Kosovës, që udhëheq bisedimet me Serbinë.

Zafir Berisha, propozoi që në këtë deklaratë të përfshihet edhe ajo që Qeveria e Kosovës duhet të rishikojë të gjitha kontaktet me shtetin serb, derisa të zgjidhet problemi, me arrestimin e z. Nehat Thaçi.

Fadil Demaku, propozoi që në këtë deklaratë të përfshihet edhe fjalia si vijon : Rruga integruese e shteteve tona është duke u dëmtuar seriozisht.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2016, ka diskutuar lidhur me rastin e arrestimit të nënkolonelit të Policisë së Kosovës, Nehat Thaçi dhe në përfundim të mbledhjes ka nxjerrë këto:

Konkluzione

Komisioni, pasi ka diskutuar rastin e arrestimit të oficerit të Policisë së Kosovës nga autoritetet serbe, shpreh shqetësimin dhe revoltën e skajshme lidhur me veprimet të tilla të shtetit serb. Komisioni kërkon që urgjentisht të lirohet oficeri Nehat Thaçi dhe u bën thirrje autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare, që të ushtrojnë tryshninë e tyre mbi Beogradin zyrtar, për ta liruar nënkolonel Nehat Thaçin, si dhe të ndërpresë praktikën e tilla të mentalitetit të vjetër. Rruga integruese, ndërshtetërore po dëmtohet seriozisht, me veprimet e tilla dhe Komisioni kërkon zbatimin e masave reciproke ndërmjet dy shteteve. Komisioni, në mënyrë unanime, miratoi këto konkluzione.

Kryesuesi, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj